




Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria e Kosovës-Vlada Kosova-Government of Kosova

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
Ministarstvo Trgovine i Industrije
Ministry of Trade and Industry

DEPARTAMENTI I TREGTISË / DEPARTAMENT TRGOVINE / DEPARTMENT OF TRADE



KOSOVA:

UDHËZUES PËR EKSPORT DHE IMPORT

Maj, 2019

Ky dokument është hartuar me mbështetjen financiare të Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Pikëpamjet e shprehura këtu nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e qeverisë së Shteteve të Bashkuara ose të USAID-it.



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA

PËRMBAJTJA

PROCEDURAT E EKSPORTIT/IMPORTIT

PARA TRAJTIMIT DOGANOR 5

Si ta regjistroni biznesin tuaj? 5

A kualifikoheni për TVSH? 6

Licencat, tarifatat dhe pagesat e aplikueshme për import,
eksport dhe tranzit të mallrave në Kosovë 6

A jeni regjistruar në Doganat e Kosovës? 7

PROCEDURAT DOGANORE TË EKSPORTIT 9

A e keni deklaruar dhe regjistruar eksportin tuaj tek Dogana e Kosovës? 9

Si të deklaroni eksportin? 10

Më shumë informacion në lidhje me deklarimin e eksporteve 11

A jeni pajisur me: 13

PROCEDURAT DOGANORE TË IMPORTIT 15

A i keni deklaruar importet tuaja? 15

A jeni pajisur me: 16

Faturat komerciale 16

Udhëzime të Detajuara për Importuesit, Eksportuesit dhe agentët doganor 16

Informacioni minimal i kërkuar në një faturë komerciale përfshin si më poshtë: 18





PROCEDURAT E EKSPORTIT/ IMPORTIT PARA TRAJTIMIT DOGANOR

Si ta regjistroni biznesin tuaj?

Pasi të keni vendosur të filloni një biznes të ri për të bërë transaksione të tregtisë ndërkombëtare, duhet të vendosni për formën e biznesit të ri. Bizneset e reja në Kosovë duhet të regjistrohen në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës (ARBK). Organizatat e biznesit mund të themelohen dhe të regjistrohen në Kosovë për çdo qëllim të ligjshëm dhe mund të kryejnë çdo aktivitet ligjor të përcaktuar në nomenklaturën e kodeve të veprimtarisë. Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës (ARBK) regjistron të gjitha bizneset e reja, bën modifikime të të dhënave të biznesit dhe mbylljeve të biznesit, dhe siguron informacione dhe forma të lira. Llojet e mëposhtme të bizneseve mund të regjistrohen në ARBK: Bizneset individuale,

“Një platformë praktike është krijuar kohët e fundit për të ndihmuar bizneset kosovare që të marrin informacionin e duhur në lidhje me procedurat e importit dhe eksportit.”

partneritetet e përgjithshme, partneritetet, shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, shoqëritë aksionare, kompanitë e huaja dhe kooperativat bujqësore. Për më shumë informacion, lidhur me biznesin e ri, ju lutemi referojuni lidhjes në vijim: <https://arbk.rks-gov.net/>.

A kualifikoheni për TVSH?

Sipas ligjit në fuqi, çdo subjekt ekonomik që planifikon të importojë ose të eksportojë duhet të regjistrohet për TVSH. Kërkesa për marrjen e Certifikatës së TVSh-së mund të bëhet në zyrat e Administratës Tatimore të Kosovës. Për t'u njohur më mirë me këtë çështje, ju lutemi konsultohuni me faqen e internetit në vijim: <http://www.atk-ks.org/>.

Licencat, tarifat dhe pagesat e aplikueshme për import, eksport dhe tranzit të mallrave në Kosovë

Një platformë praktike është krijuar kohët e fundit për të ndihmuar bizneset kosovare që të marrin informacionin e duhur në lidhje me procedurat e importit dhe eksportit. Duke vepruar kështu, ju lutemi shihni lidhjen e mëposhtme: <http://itg-rks.com>.

Megjithatë, nën Qeverinë e Republikës së Kosovës ekzistojnë 11 ministri të ndryshme, agjenci që lëshojnë licenca të ndryshme dhe aplikojnë tarifa dhe pagesa për importin, eksportin dhe tranzitin e mallrave në Kosovë.

- Ministria e Tregtisë dhe Industrisë - Departamenti i Tregtisë;
- Ministria e Tregtisë dhe Industrisë - Departamenti i Rregullimit të Tregut të Naftës;
- Ministria e Tregtisë dhe Industrisë - Departamenti i Kontrollit, Tregtimit të Mallrave Strategjike;
- Ministria e Punëve të Brendshme - Departamenti i Sigurisë Publike;
- Dogana e Kosovës - Departamenti i Akcizës;
- Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë;
- Agjencia e Kosovës për produkte dhe pajisje medicinale;
- Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;

- Ministria e Infrastrukturës Departamenti i Transportit tokësor;
- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
- Agjencia e Kosovës për Mbrojtjen nga Rrezatimi dhe Siguria Bërthamore

A jeni regjistruar në Doganat e Kosovës?

Pas dorëzimit të certifikatës së biznesit dhe TVSH-së, një subjekt ekonomik duhet të kërkojë nga doganat e Kosovës që të aktivizojnë të dhënat e tyre në sistemin elektronik ASYCUDA World të Doganës të Kosovës.







PROCEDURAT DOGANORE TË EKSPORTIT

A e keni deklaruar dhe regjistruar eksportin tuaj tek Dogana e Kosovës?

“Procedurë doganore” është veprimi juridik për të bërë lirin e mallrave nga “kontrolli doganor”. Kontrolli doganor i referohet masave të zbatuara për të siguruar përputhjen me ligjet dhe rregulloret e Republikës së Kosovës, në lidhje me importimin, eksportimin ose tranzitin e mallrave. Pavarësisht nga procedura doganore që një tregtar dëshiron të aplikojë për një dërgesë, një deklaratë e mallrave doganore kërkohet të plotësohet nga një importues ose eksportues (ose një përfaqësues i autorizuar në mënyrë të rregullt) dhe të regjistrohet pranë Doganës së Kosovës për një dërgesë që të lirohet nga kontrolli doganor. Vlen të përmendet se në përgatitjen e deklaratës doganore të mallrave, tregtari duhet së pari të përcaktojë dhe deklarojë se cila procedurë doganore duhet të deklarohet për

“Lirimi për eksport do të jepet nga Dogana me kusht që mallrat në fjalë të largohen nga Kosova në të njëjtën gjendje si kur është paraqitur dhe pranuar deklarata e eksportit.”

trajtimin e mëtejshëm të mallrave. Shembujt e procedurave doganore të cilat mund të aplikohen për një dërgesë mallrash, përfshijnë ndër të tjera, importimin, eksportimin, tranzitin, importin e përkohshëm, deponimin, trans-ngarkimin, riekportimin, tërheqjen e detyrimeve dhe përpunimin e brendshëm.

Si të deklaroni eksportin?

Deklaratat e eksportit mund të paraqiten në zyrën doganore përgjegjëse për mbikëqyrjen e vendit ku është i vendosur eksportuesi, ose zyrën doganore ku mallrat janë të paketuara ose ngarkuar për eksport. Lirimi për eksport do të jepet nga Dogana me kusht që mallrat në fjalë të largohen nga Kosova në të njëjtën gjendje si kur është paraqitur dhe pranuar deklarata e eksportit. Eksportuesi konsiderohet të jetë personi në emër të të cilit është bërë deklarata e eksportit dhe i cili është pronar i mallrave ose ka të drejtën e asgjësimit të tyre gjatë kohës kur deklarata është paraqitur pranë Doganës. Kur pronësia ose e drejta e asgjësimit të mallit i përketin një personi të vendosur jashtë Kosovës sipas kontratës në

të cilën është bazuar eksporti, eksportuesi do të konsiderohet si palë kontraktuese e themeluar në Kosovë.

Më shumë informacion në lidhje me deklarimin e eksporteve

Kur formalitetet e eksportit nuk janë plotësuar në zyrën doganore përgjegjëse për mbikëqyrjen e vendit ku është vendosur eksportuesi ose ku mallrat janë të paketuara ose ngarkuar për dërgesë të eksportit, zyra doganore ku është paraqitur deklarata e eksportit do të dërgojë një kopje të Doku-

mentit Unik Doganor (DUD) në zyrën e parë doganore të përmendur. Kur deklarata e eksportit bëhet në bazë të DUD-it, do të përdoren kopjet 1, 2 dhe 3. Zyra doganore ku është paraqitur deklarata e eksportit (zyra doganore e eksportit) do të vulosë kutinë A dhe, kur është e përshtatshme, të plotësojë Kutinë D. Për dhënien e lirit të mallrave, ajo do të mbajë kopjet 1 dhe 2 dhe do të kthejë kopjen 3 personit në fjalë. Kopja 3 e DUD-it dhe malli i lëshuar për eksport do t'i paraqitet Doganës në zyrën doganore të daljes. Zyra doganore e daljes nënkupton në rastin e mallrave të eksportuara nga:

(a) Hekurudhor, post ose ajër, zyradoganore kompetente për vendin ku mallrat janë marrë në bazë të një kontrate të vetme transporti për transport në një vend tjetër nga kompanitë hekurudhore, autoritetet postare ose kompanitë e linjave ajrore.

(b) Tubacioni dhe energjia elektrike, zyra ku është vendosur eksportuesi.

(c) Mjete të tjera ose në rrethanat që nuk mbulohen nga (a) dhe (b), zyra e fundit doganore përpara se mallrat të largohen nga Kosova.

Zyra doganore e eksportit mund t'i kërkojë eksportuesit të ofrojë dëshmi se mallrat janë larguar nga Kosova. Vlen të përmendet se deklaratat gojore mund të bëhen vetëm në zyrën doganore të daljes. Në këtë rast kur mallrat largohen nga Kosova pa një deklaratë eksporti, deklarata e tillë duhet të paraqitet në mënyrë retrospektive nga eksportuesi në zyrën doganore kompetente për vendin ku është vendosur.

Pranimi i kësaj deklarate do të jetë subjekt i paraqitjes nga eksportuesi, për satisfakcionin e zyrës doganore në fjalë, të provave në lidhje me natyrën dhe sasinë e mallrave në fjalë dhe rrethanat nën të cilat ato u larguan nga Kosova. Kjo zyrë do të miratojë gjithashtu kopjen 3 të DUD-it. Pranimi retrospektiv i deklaratës nuk do të përjashtojë zbatimin e ndëshkimeve të zbatueshme.

Kur mallrat e lëshuara për eksport nuk largohen nga Kosova, eksportuesi menjëherë do të informojë zyrën doganore të eksportit. Kopja 3 e DUD-it në fjalë do të kthehet në atë zyrë.

Kur një ndryshim në kontratën e transportit ka efektin e ndërprerjes brenda Kosovës të njëaktiviteti transporti i cili duhet të ketë përfunduar jashtë vendit, kompanitë ose autoritetet në fjalë mund të kryejnë vetëm kontratën e ndryshuar me marrëveshjen e zyrës doganore të daljes, kurse në rastin e një operacioni tranziti, zyrësë nisjes. Në këtë rast kopja 3 duhet të kthehet.

A jeni pajisur me:

- Deklaratë unike doganore / dokumenti i vetëm administrativ
- Një faturë komerciale
- EUR 1 / certifikatën e origjinës
- CMR

Sistemi i TI ASYCUDA World, i përdorur nga Dogana, ka funksionalitetin e quajtur “lirimi i eksportit” nëpërmjet të cilit zyrtari doganor në postën e kontrollit të kufirit do të konfirmojë që mallrat janë larguar nga territori i Kosovës. Një qasje më e sofistikuar gjithashtu mbështetet nga sistemi ASYCUDA, i cili konsiston në përdorimin e procedurës T1 (dhe llogaritë e garancisë), për të mbuluar lëvizjen e mallrave (të deklaruara për eksport) nga një terminal doganor në postën e kontrollit kufitar të daljes. Në këtë rast, T1 gjenerohet automatikisht nga deklarata e vlerësuar e eksportit dhe duhet të mbyllet në kontrollin kufitar pas daljes. Edhe në këtë rast, operacioni “Lëshimi i eksportit” kryhet më pas nga Dogana.

“Vlen të përmendet se deklaratat gojore mund të bëhen vetëm në zyrën doganore të daljes.”





PROCEDURAT DOGANORE TË IMPORTIT

A i keni deklaruar importet tuaja?

“Procedurë doganore” është veprimi juridik për të bërë lirimin e mallrave nga “kontrolli doganor”. Kontrolli doganor i referohet masave të zbatuara për të siguruar përputhjen me ligjet dhe rregulloret e Republikës së Kosovës, në lidhje me importimin, eksportimin ose tranzitin e mallrave. Pavarësisht nga procedura doganore që një tregtar dëshiron të aplikojë për një dërgesë, një deklaratë e mallrave doganore kërkohet të plotësohet nga një importues ose eksportues (ose një përfaqësues i autorizuar në mënyrë të rregullt) dhe të regjistrohet pranë Doganës së Kosovës për një dërgesë që të lirohet nga kontrolli doganor. Vlen të përmendet se në përgatitjen e deklaratës doganore të mallrave, tregtari duhet së pari të përcaktojë dhe deklarojë se cila procedurë doganore duhet të deklarohet për trajtimin e mëtejshëm të mallrave. Shembujt e procedurave doganore të cilat mund të

aplikohen për një dërgesë mallrash, përfshijnë ndër të tjera, importimin, eksportimin, tranzitin, importin e përkohshëm, deponimin, trans-ngarkimin, rieksportimin, tërheqjen e detyrimeve dhe përpunimin e brendshëm.

A jeni pajisur me:

- Deklaratë unike doganore / dokumenti i vetëm administrativ
- Një faturë komerciale
- EUR 1 / certifikatën e origjinës
- CMR

Faturat komerciale

Informacioni i dhënë në këtë seksion zbatohet për fatura komerciale që janë përgatitur në lidhje me transaksionet e importit dhe eksportit. Informata më të mira për faturat e importit ose eksportit do të lehtësojnë lëshimet më të shpejta të ngarkesave në vendin e destinacionit. Sa më i mirë informacioni i dhënë në fatura komerciale, zyrtarët doganor do të jenë në gjendje që më shpejtë të verifikojnë

të dhënat e deklaruara dhe dërgesat do të procedohen dhe lirohen më shpejtë.

Udhëzime të Detajuara për Importuesit, Eksportuesit dhe agentët doganor


Është përgjegjësi e tregtarëve ose përfaqësuesve të tyre që të përgatisin një dokument administrativ të plotë dhe të saktë (DUD) për procedimin e të gjitha dërgesave, qoftë në import, eksport, tranzit, deponim apo procedura të tjera doganore. Një nga kërkesat për paraqitjen e një deklarate të pranueshme është përfshirja e një kopje të një fature komerciale dhe certifikatës së origjinës, përveç çdo leje, licence ose certifikatë të kërkuar që i përket mallrave. Fatura komerciale duhet të ofrojë një përshkrim të saktë dhe të plotë të mallrave dhe të sigurojë disa informata themelore që kanë të bëjnë me këto mallra. Fatura duhet gjithashtu të sigurojë çmimin e vërtetë dhe të plotë të paguar ose të pagueshëm për çdo lloj të mirë të shënuar në faturë. Dështimi për të siguruar faturat e duhura komerciale, të cilat në mënyrë adekuate përshkruajnë mallrat kur paraqitet deklarata

doganore, mund të rezultojë në refuzimin e menjëhershëm. Në çdo rast përpunimi dhe miratimi i një deklarate pa faturë të duhur, ose informacioni i papërshtatshëm ose i paplotë i faturave mund të çojë në pagesë të tepërt të detyrimeve të importit, TVSH dhe, nëse aplikohet, akcizës. Në mënyrë që Dogana të ofrojë shërbime të mira në procedimin e mallrave të importuara ose të eksportuara, është thelbësore që secili deklarues të sigurojë që fatura (at) e dorëzuar me DUD-in të përshkruajë saktësisht mallrat e mbuluara nga transaksioni. Përshkrimi i faturës duhet të jetë mjaft i detajuar për një zyrtar doganor, që ai të jetë në gjendje të klasifikojë saktë mallrat sipas Nomenklaturës së Sistemit të Harmonizuar të Tarifës Doganore. Nëse informacioni i faturës dhe përshkrimet e mallrave nuk jepen në detaje të mjaftueshme, përpunimi i deklaratës doganore mund të shtyhet, gjë që natyrisht rezulton me kohë dhe kosto shtesë në bërjen e biznesit. Së fundi, faturat duhet të jenë mjaft të qarta për të lejuar zyrtarët e doganave të kryejnë funksionet e tyre të përpunimit dhe verifikimit. Për shembull, ky nuk është një problem me faturat e dorëzuara në mënyrë elektronike.

“Nëse informacioni i faturës dhe përshkrimet e mallrave nuk jepen në detaje të mjaftueshme, përpunimi i deklaratës doganore mund të shtyhet.”

Informacioni minimal i kërkuar në një faturë komerciale përfshin si më poshtë:

- Emri i Furnizuesit (furnizuesi, dërguesi) në një vend të huaj.
- Emri i eksportuesit, nese eshte ndryshe nga shitësi.
- Emri i Marrësit në Kosovë.
- Emri i blerësit, nëse është i ndryshëm nga marrësi.
- Numri i porosisë së blerjes, nëse është e aplikueshme.
- Data e dërgesës së drejtpërdrejtë në Kosovë.
- Vendi i transportit, nëse është e aplikueshme.
- Vendi i Origjinës (ku mallrat janë rritur, ose prodhuar, nëse dërgesa përfshin mallra me origjinë të ndryshme, origjina duhet të jepet me përshkrimin narrativ për çdo lloj malli në dërgesë, siç tregohet në pikën 14 më poshtë).
- Transporti - tregoni mënyrën e transportit dhe vendin e dërgesës së drejtpërdrejtë në Kosovë.
- Kushtet e shitjes.
- Kushtet e pagesës (për shembull “shitje”, “ngarkesë”, “qira”, “kredi” dhe neto 30 ditë, etj.).
- Valuta e vendit.
- Numri i Paketave.
- Përshkrimi i Mallrave (duke përfshirë Llojin e Paketave, Markave dhe Numrave, Karakteristikat, Shkalla, Cilësia, numri gjashtë shifror i SH).
- Sasia dhe Njësia e Matjes.
- Pesha totale (neto dhe bruto).
- Vlerat e Njesisë.
- Fatura Total (FOB - në Valutën e Zgjidhjes).
- Deklarata e Çmimit (në rastet kur një taksë ose një pagesë tjetër ose një procedurë e mëpasshme, paguhen ose janë të pagueshme nga blerësi në Kosovë për këto mallra).





SI MUND TË NA KONTAKTONI?

Departamenti i Tregtisë gjendet në objektin e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.

Adresa: Lagjja e Spitalit,
Rr. "Muharrem Fejza" Zyra: 112 A,
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës.

Departamenti i Tregtisë mund të kontaktohet
edhe përmes e-mail adresës: tregtia@rks-gov.net;
ose numrave të telefonit: +383 (0) 38 200 36 623;
+383 (0) 38 200 36 624; +383 (0) 38 200 36 519.